



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:280758

Datë: 07.12.2024

Numri i dokumentit: 06563886

C.nr.611/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Petrit Curri, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit A.K.fshati B., Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 07.12.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K.fshati B., Komuna e Malishevës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që paditësit **A.K.** t'ia paguaj borxhin në emër inflacionit, për periudhën kohore si në vijim:

për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej **10.68 euro**,

për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej **182.88 euro**,

për periudhën kohore Janar- Shtator 2022 në shumën prej **512.46 euro**, në shumën e përgjithshme prej **706.02 €**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar në emër të inflacionit për paditësin për periudhën e vitit 2019 në shumën prej 145.20 euro.

IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi A.K.fshati B., Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të saj Av. Agron Kryeziu nga Malisheva në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim mbi bazën e inflacionit, sipas padisë paditësja është punëtoare e arsimit në SHFMU “Dëshmorët e Fshatit B.” në fshatin B., andaj meqenëse e paditura nuk i ka përmbushur pagesën e përqindjës në emër të inflacionit, të cilat të drejta janë të garantuara me kontratën kolektive të arsimit, e cila është baza juridike e kësaj padie, gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe atë si vijon: për periudhën Janar-Dhjetor 2019, për $2.7\% \times 448.39$ (paga bazë) = 12.10×12 muaj = 145.20 €, për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për $0.2\% \times 448.39$ (paga bazë) = 0.89×12 muaj = 10.68 €, periudhën Janar-Dhjetor 2021, për $3.4\% \times 448.39$ (paga bazë) = 15.24×12 muaj = 182.88 €, periudhën Janar-Nëntor 2022, për $11.6\% \times 448.39$ (paga bazë) = 56.94×9 muaj = 512.46 €.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, ndërsa të njëjtat nuk i ka precizuar.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi në këtë rast e lidhur më pagesën e inflacionit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive dhe në bazë të nenit 35 pika 10 e kësaj kontrate e vitit 2021, nuk kemi të dhëna çka dhe më të vërtetë duhet të paguhet ky inflacion apo në sa është përqindja dhe në këtë padi nuk ka prova konkrete zyrtare nga institucionet e Kosovës -BQK çfarë rritje ekonomike ka pasur në Kosovë dhe së qfarë përqindje të inflacionit duhet paguar dhe çka është paraparë në këtë rast. Konsiderojmë që rastin konkret kjo padi është bërë vetëm në bazë të supozimeve dhe nuk ka të bëjë asgjë më inflacion, pasi nuk ka të dhëna se ku duhet të mbështet kjo përqindje e rritjes së inflacionit dhe kjo norme e kontratës kolektive nuk zbatohet, Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borgjit lidhur më këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi që palet të cilet e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruaj këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj ,e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK më datë 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, poashtu, MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e komunave më dt: 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kesaj kontrate kolektive, poashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës, kolektive të arsimit kemi të bëjmë më parashkrim në bazë të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së dhe kjo si kërkesë padi është e pasaftshme pasi që ky borgj është kërkuar që nga viti 2017 , ndërsa padi është paraqitur në vitin 2023 pra këtë rast edhe po qe se aprovohet padia kemi të bëjmë më parashkrim për vitin 2017-18 ,ndërsa kontrata kolektive e vitit 2021 është ndërpre më dt: 21.11.2022, pra është paraqitur kjo kërkesë padi pas ndërprerjes së kontratës kolektive, i ka propozuar gjykatës të refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Kontratën e Punës nr.11/955 të datës 25.09.2015 dhe Listën e Pagës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa e aprovojë pjesërisht për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të inflacionit, andaj nga provat e administruara, si dhe bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit në emër të inflacionit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit të shujtave, andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësve.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi pjesërisht të bazuara, përkatësisht gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit për periudhën për vitin 2019 është e parashkruar, ngase në vështrim të shkresave të lëndës, konstatohet se paditësi padinë e ka parashtruar në vitin 2023, ndërsa kërkesa e padisë rezulton e kërkuar nga viti 2019 ndërsa sa i përket kërkesave pas vitit 2019 për gjykatën padia rezulton e afatshme e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e mjeteve në emër të inflacionit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shpëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë

realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t'ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën prej 104.00 euro në emër të parashtrimit të padisë dhe shumën prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.611/23 me datën 07.12.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.